



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr 559/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, Vedat Poterqoi –Referues dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: (OE) "Lulishtja LABI-A sh.p.k" Prishtinë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) Njoftimit për dhëni të kontratës për aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi dhe rregullimi i oborreve për institucionet arsimore", me nr. të prokurimit: 616-22-8446-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 06 Dhjetor 2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa e OE "Lulishtja LABI-A sh.p.k" Prishtinë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) Njoftimit për dhëni të kontratës për aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi dhe rregullimi i oborreve për institucionet arsimore", me nr. të prokurimit: 616-22-8446-1-2-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë.

Vërtetohet vendimi i AK-së B08-Njoftim për dhënie të kontratës i datës 28.09.2022, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi dhe rregullimi i oborreve për institucionet arsimore", me nr. të prokurimit: 616-22-8446-1-2-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë.

Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuara në emër të tarifës për ankesë, të Operatorit Ekonomik "Lulishtja LABI-A sh.p.k" Prishtinë, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Operatori ekonomik ankues “Lulishtja LABI-A sh.p.k” Prishtinë, si palë e pa kënaqur me datën 19.10.2022 ka parashtruar ankesë në OSHP , anesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër 559/2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe rregullimi i oborreve për institucionet arsimore”, me nr. të prokurimit: 616-22-8446-1-2-1, iniciuar nga AK Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar që AK ka vepruar në kundërshtim me:

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

- vlerësimi dhe administrimi i provave-

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 16.11.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE të refuzohet si e pa bazuar
- Vendimi i AK-së b58- Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 28.09.202, të mbetet në fuqi.

Raporti i vlerësimit i cituar si më sipër, është pranuar nga të dyja palët, me ç ‘rast OE me datën 18.10.2022, ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin, kurse AK me 18.10.2022 ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në fakt, ankuesi me shënime si më sipër, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të AK –së të datës 10.10.2022 ndërlidhur me Vendimin e AK-së B58- Njoftimi për dhënie të kontratës (datë si më sipër) duke pohuar mes tjerash se: (a) gjatë rrjedhjes së këtij aktiviteti të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 1,6,7,59,60,69 dhe 72 të LPP .

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe shoshitjes së provave në tërësi konstaton se

duke marr për bazë faktin, se OE ankues nuk ka arritur te dëshmoj me ane te asnjë dëshmie – prove konstatimet e ekspertit shqyrtues duke mos ofruar asnjë dëshmi bindëse që do te ndryshonte konstatimet e ekspertit shqyrtues paneli shqyrtues i fali besimin ekspertit shqyrtues për te gjitha përgjigjet e dhëna për te gjitha pretendimet e OE ankues.

Paneli shqyrtues konstatoi se marr parasysh faktin se OE ankues nuk kishte plotësuar disa nga kërkesat e dosjes së tenderit dhe te njoftimit për kontratë , AK kishte vepruar në pajtim me nenin 59 të LPP-së kur e kishte eliminuar te njëjtin OE me ç'rast ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i ofertave ishte bere në pajtim me ketë dispozitë.

Paneli shqyrtues konstaton, se edhe përkundër faktit se OE ankues kishte ofertuar me çmim me të ulet nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës , plotësimi i kriterit te çmimit me te ulet nuk i jep te drejte AK-së që te rekomandoj për dhënie te kontratës një operator ekonomik sepse AK mund te rekomandoj për dhënie të kontratës vetëm atë operator ekonomik i cili fillimisht ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosje së tenderit dhe njoftimit për kontrate dhe njëkohësisht ka ofertuar edhe me çmim me të ulet. Andaj paneli shqyrtues konstaton se vlerësimi i ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë nga ana e AK-së është bere në pajtim me nenin 1, 7 dhe 59 të LPP-së.

Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues erdhi në përfundimin se AK ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e LPP-së me rastin e ekzaminimi, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave dhe në pajtim me LPP-në ka bere edhe publikimin e Njoftimit B58 të datës 28.09.2022, andaj si te tillë paneli e vërteton ketë vendim-Njoftim dhe ankesën e OE ankues e refuzon si të pa bazuar .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit shqyrtues

Vjosa Gradinaj Mexhuani

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimt të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

1x1 AK – Kuvendi Komunal Prishtinë

1x1 OE- “Lulishtja LABI-A sh.p.k” Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së